



REPUBLIKA E ALBANIËS

**THE OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP  
NATIONAL ACTION PLAN FOR ALBANIA  
2020 – 2022**

**COMPONENT 1: ANTI-CORRUPTION  
PRE-CONSULTATION REPORT**



## **I. Hyrje dhe historik**

### ***Përshkruani shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të komponentit dhe të nën-komponentëve:***

Komponenti Antikorrupsioni është i ndërlidhur me zbatimin e një prej reformave në RSH, lufta kundër korrupsionit, edhe si një prej kushteve të vendosura në kuadër të procesit të integrimit. Shqipëria ka miratuar në datë 1.7.2020, Planin e ri të Veprimit Antikorrupsion 2020-2023, një dokument që intensifikon masat dhe ndërhyrjet për të forcuar luftën kundër korrupsionit në të tre qasjet e strategjisë, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim.

Komponenti 1 i planit të veprimit OGP, 2020-2022, përbëhet nga dy objektiva specifike: 1- planet e integritetit dhe 2- pronarët përfitues. Objektivi 1 është nën përgjegjësinë e MD dhe objektivi 2 është nën përgjegjësinë e MFE.

Objektivi 1: Planet e Integritetit janë identifikuar duke siguruar në këtë mënyrë një ndërlidhje të këtij plani veprimi me Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe planin e saj të veprimit, 2020-2023, një instrument esencial në luftën kundër korrupsionit në administratën publike.

### ***Përshkruani shkurtimisht të kaluarën dhe sfidat aktuale që kanë penguar angazhimin e palëve të interesuara në të kaluarën në këtë komponent:***

Hartimi dhe zbatimi i planeve të integritetit në institucionet e administratës publike (shtetërore) është një ndër objektivet specifike të qasjes parandaluese, të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Këto janë mekanizma të garantimit të luftës së korrupsionit, dhe ofrojnë bashkëpunime shumë të mira me OSHC dhe vetë publikun e gjerë.

Hartimi dhe zbatimi i tyre nuk është bërë i mundur më parë për shkak të mosangazhimit dhe prioritizimit të tyre në funksionimin e organeve të administratës, evidentimit të problematikave që mungesa e planit të integritetit sjell në ecurinë e proceseve të punës që ndjek një institucion dhe pasjelljen si pasojë të rasteve për korrupsion në administratë.

### ***Çfarë hapash janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida?***

Me rishikimin e planit të veprimit antikorrupsion 2020-2023, u theksua rëndësia e zbatimit të këtij instrumenti dhe aplikimin së pari në Ministrinë e Drejtësisë dhe zbatimin në vijim edhe në ministritë e tjera.

Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kundër Korrupsionit, është institucioni pilot që do të ketë dhe do të zbatojë një plan integriteti. Metodologjia e saj do të shtrihet me tej dhe do të zbatohet në vijim edhe nga ministritë e tjera.

## **II. Metodologjia**

### **II.1. Përshkrimi i pyetësorit:**

#### ***Pyetjet e përfshira (bashkëngjitni si aneks nëse preferoni dhe diskutoni pyetjet në terma të përgjithshëm)***

Lutem gjeni bashkëlidhur dokumentin: Pyetësor për komponentin 1 të PV OGP 2020-2023: Planet e integritetit.

Pyetjet në përbërje të pyetësorit janë për të evidentuar procesin dhe rëndësinë e pasjes së këtij instrumenti në luftën kundër korrupsionit në administratë; qëllimi është për të kuptuar se kush mund të përfshihen në hartimin dhe ndjekjen për të garantuar zbatimin e tyre; si mund të përthithet asistenca dhe bashkëveprimi me organizata të shoqërisë civile, si edhe fushat konkrete që mund të përbëjnë risk për raste korrupsioni.

***Pse u zgjodhën këto pyetje:***

Këto pyetje janë përzgjedhur për të mundësuar ndërveprimin dhe garantuar bashkëpunim për hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në administratën publike.

***Cili është rezultati i pritshëm i sondazhit:***

Të garantohet dhe mundësohet bashkëpunim për të evidentuar rëndësinë e hartimit të këtij instrumenti në luftën kundër korrupsionit. Të bashkërendohet procesi dhe të sigurohet zbatimi i tyre.

**II.2. *Përzgjedhja e palëve të interesuara:***

***Si u përzgjedhën palët e interesuara?***

Lista e adresave drejtuar pyetësori është hartuar në bazë të bashkëpunimit të Koordinatorit Kundër Korrupsionit në fushën e politikave AK. MD/KKK konsulton dokumentet e saj të politikave AK me OSHC, ka të konstituuar Forumin e Shoqërisë Civile për AK, pranë saj. Në këtë rrjet janë OSHC me aktive e fushën AK.

***Cilët organiazata u kontaktuan dhe pse?***

Lutem gjeni bashkëlidhur listën e OSHC AK, ku janë të gjithë organizatat e kontaktuara për të dhënë komente dhe mendimet mbi propozimin e bërë.

**III. Rezultatet e para**

***Përmbledhje e të dhënave të marra nga palët e interesuara:***

Nga procesi i parakonsultimit në linkun në të cilin është shpallur drafti paraprak rezulton një feedback paksa i kufizuar. Janë vetëm dy organizata që kanë aksesuar linkun dhe kanë adresuar përgjigje për pyetjet dhe kërkesat e shtruara, nga një listë me 34 të tilla.

Përgjigjet janë të balancuara për rolin e punonjësve të administratës në hartimin e Planeve të Integritetit; fushat me risk për korrupsion nga mungesa e PI janë përzgjedhja dhe rekrutimi i punonjësve, performanca në detyrë, keqpërdorim i buxhetit të shtetit, çfarë asistence mund të ofrojnë ato/ato si OSHC, kush mund të konsiderohen prioritete në zbatimin e PI, si dhe është propozuar një masë e mundshme për tu përfshirë në PI.

***Çështjet kryesore të identifikuara nga palët e interesuara:***

Problematikë është evidentuar çështja e zbatimit të PI dhe se si OSHC mund të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e PI.

***Rekomandimet kryesore të palëve të interesuara:***

OSHC kërkojnë më shumë kohë dhe takime të organizuara në afate kohe reale dhe performance të shtuar për të folur dhe diskutuar për këtë dokument.

***Fushat e rekomanduara fazat e mëvonshme:***

Takime pune dhe tryeza diskutimi për procesin e hartimit të PI por dhe për zbatimin e dokumentit.

#### **IV. Mangësitë e identifikuara**

***Kufizimet në përgjigjet / nën-përfaqësimin e palëve të interesuara:***

Nga 34 organizata, vetëm 2 kanë kthyer përgjigje.

***Pa përgjigje:***

Pyetja 3 mbetet pa përgjigje fare (0 përgjigje).

***Përgjigje të paragjykuara:***

Nuk ka.

#### **V. Prgatitjet për fazat e ardhshme**

***Çfarë duhet përmirësuar në fazat e ardhshme?***

Drafti i PV do të rishikohet me qëllimin për të modifikuar masat ekzistuese dhe/apo hartuar të reja duke marrë si indicie të mundshme kontributin e marë nga procesi i parakonsultimit të deritanishëm.

Takime konsultimi do të planifikohen në vijim.

***Si do të sigurohet bashkëpunimi me takimet?***

Do të planifikohen takime konsultimi dhe drafti do të shpërndahet paraprakisht për mendime dhe komente tek OSHC-të.

***Çfarë hapash do të ndërmerren për të promovuar angazhimin nga palët e interesuara?***

Organizimi i tryezave të hapura dhe të organizuara mjaftueshëmrisht në kohë përgatitore.

## **VI. Annex 1: Lista me emërtimet e OSHC-ve për drejtorinë Anti Korrupsion**

1. Instituti per Demokraci dhe Ndermjetesim - IDM Albania
2. Komiteti Shqiptar i Helsinkit/ Albanian Helsinki Committee
3. Nisma Thurje
4. Partneret Shqiperi per Ndryshim dhe Zhvillim/ Partners Albania for Change and Development
5. Inistituti i Politikave Publike dhe Private
6. Instituti i Studimeve Politike
7. Center for Legal Civic Initiatives
8. Albanian Human Rights Group
9. Albanian Policy Center
10. Levizja MJAFT
11. AIIS - Albanian Institute for International Studies
12. PIRE - Pacific Institute for Research and Evaluation
13. Res Publica
14. Young Intellectuals/ National Council for Civil Society
15. Center of Public Impact (Qendra per Ndikim Publik)
16. Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)
17. Albanian Center for Economic Studies
18. INFOCIP- Qendra per Ceshtjet e Informimit Publik
19. Fondacioni Shoqeria e Hapur per Shqiperine/Open Society Foundation Albania
20. Civil Rights Defender
21. Shoqata Delfini" Diber
22. Qendra Europiane
23. Qendra Alterum
24. ALTRI
25. Instituti i Studimeve Publike Ligjore
26. MJAFT
27. ICC Albania
28. QNL
29. New Bridges Berat
30. LIBURNETIK
31. NDI Albania
32. EMA
33. ACER
34. CDI